



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Patos, më ___/___/2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT 1
(PAS PROCESIT TË ANKIMIT)

Datë: 07/02/2022

Drejtuar: **B. O. E.** "AIDA CONSTRUCTION" shpk dhe "6D-PLAN" shpk

Procedura e prokurimit/lotit: Tender i hapur

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

REF-09096-10-21-2021

"Rikonstruksion i ambienteve të Qendrës Shëndetësore Ruzhdie dhe Ambulancës në Dukas Çoban".

Afati : 3(tre) muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- Shoqëria "Spektri" Shpk me nr. NIPT J62903555F nuk ka ngarkuar asnjë ofertë në sistem.
- Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: "ASI-2A CO" shpk me nr. NIPT-K53002402C dhe "GENTI 001" me nr. NIPT L93101401U ofron vlerën sipas preventivit **8,983,505.01** (tete milion e nenteqind e tetedhjetë e tre mijë e peseqind e pese pike zero nje) lekë pa TVSH.
- Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: "MODESTE" shpk me nr. NIPT-i J62903413B dhe "SHKELQIMI 07" me nr. NIPT K68121808W ofron vlerën sipas preventivit **9,599,066.36** (nente milion e peseqind e nentedhjetë e nente mijë e gjashtedhjetë e gjashtë pike tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

¹ Ky Formular është i aplikueshëm nëse ka Ankime

- Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: **“AIDA CONSTRUCTION” shpk** me nr.NIPT-i M03116403L dhe **“6D-PLAN” shpk** me nr.NIPT-i L62717405H ofron vlerën sipas preventivit **11,973,509.42** (njembedhjetë milion e nentëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e nente pike dyzete e dy) lekë pa TVSH.

* * *

Nga pjesërmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: **“ASI-2A CO” shpk** me nr. NIPT-K53002402C dhe **“GENTI 001”** me nr. NIPT **L93101401U** kishte mangësi të dokumentacionit si me poshtë :

1. Nuk ploteson piken 2.2.3, për shlyerjen e taksave, pasi operatori ASI-2A CO nuk ka vetedeklaruar dhe as nuk ka paraqitur vertetimin e shlyerjes së taksave nga Bashkia .
2. Nuk ploteson piken 2.3.5 mbi disponimin e punonjesve të specializuar, pasi ndarja e punonjesve nuk është bërë sipas % dhe llojit të punimeve që ka marrë për të realizuar secilin operator. Sipas ndarjes së punimeve të preventivit, operatori “Genti 001” shpk merr për të punuar vetëm punimet e prishjes dhe gërmimit dhe “ASI-2A CO” shpk gjithë punimet e tjera, që do të thotë që Operatori “ASI-2A” shpk duhet të dispononte 4 suvatues, por disponon vetëm 2 të tilla, 3 pllakashtrues nga 4 të kërkuar, 2 bojaxhinj nga 4 të kërkuar.
 - a. Në shtojcën 8, “GENTI 001” ka deklaruar si specialist dy punonjes Besnik Shkëmbi dhe Veis Metaj, ku thuhet me profesion suvatues por të punësuar si pllakashtrues, dhe nuk ka asnjë dokument shoqëruar për të vertetuar punën apo rolin e saktë të këtyre specialistëve të punësuar (suvatues apo pllakashtrues).

Sa i përket specialistëve shofer dhe manovrator, ASI-2A CO ka deklaruar se disponon 2 kamiona dhe 2 fadroma, cka do të thotë që duhet të disponojë 2 shofere dhe 2 manovratorë ndërkohë që disponon vetëm 1 shofer dhe 1 manovrator. Genti 001 ka deklaruar 3 shofere dhe 1 manovrator por s'ka asnjë fadromë dhe kamionat e kamioncinat nuk janë të deklaruara sipas specifikave të kërkuara, pra nuk përcaktohet tonazhi për kamionet dhe kamioncinat e kërkuara dhe s'ka dokumentacion shtesë për ta vertetuar.

- Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: **“MODESTE” shpk** me nr. NIPT-i J62903413B dhe **“SHKELQIMI 07”** me nr. NIPT K68121808W kishte mangësi të dokumentacionit si me poshtë :

1. Në formularin e vetedeklarimit , operatori “Shkelqimi 07” nuk ka dhënë referencat për deklaratën se nuk është i dënuar për vepra penale, vendim gjyqësor të formës prërë mbi veprimtarinë profesionale dhe personi/personat që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori, mbikqyresit ose ortaku etj, ka fuqi përfaqësuese, vendimarrëse..., nuk është i dënuar apo ka qenë i dënuar për vepra penale etj dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion shtesë për ta vertetuar këtë.

- a. Gjithashtu pika D, për zbatimin e dispozitave ligjore mbi marrëdhëniet e punës, vetëklarimi se operatori nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektoriati shtetëror i punës është deklaruar JO nga të dy operatorët në bashkëpunim.
 2. Nuk plotëson pikën 2.3.5 mbi disponimin e punonjësve të specializuar, pasi operatori “Shkelqimi 07”, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit dhe ndarjes së preventivit ka marrë për siper punime prishje, germimi, hidrosanitaret, kanalizimi dhe elektrike ndërkohe nuk disponon asnjë punëtor të thjeshtë, sika asnjë hidraulik nga 2 të kërkuar, ka 2 elektrikiste nga 4 (kater) të kërkuar. Shoqëria “Modeste” disponon 2 kamiona, 1 kamioncine dhe 1 fadrome por nuk disponon asnjë shofer dhe manovrator.
- Shoqëria “Spektri” Shpk me nr. NIPT J62903555F kishte mangesi të dokumentacionit si më poshtë :
1. Nuk plotëson pikën 2.3.3 pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbi disponimin e personelit kryesor drejtues teknik.
 2. Nuk plotëson pikën 2.3.4, pasi nuk disponon staf mbështetës (topograf).
 3. Pikën 2.3.5, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbi disponimin e punonjësve të specializuar.
 4. Pikën 2.3.6, pasi nuk disponon nr. minimal të fuqisë punëtore të kërkuar.
 5. Pikën 2.3.7, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbi mjetet dhe pajisjet e kërkuara.
 6. Pikën 2.3.8, nuk disponon licensë profesionale me Kod III.2.B.
 7. Nuk ka paraqitur formularin e vetëdeklarimit.
 8. Nuk ka paraqitur sigurimin e Ofertes, sipas shtojcës 3
 9. Nuk ka paraqitur asnjë ofertë ekonomike.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: **“AIDA CONSTRUCTION” shpk** me nr.NIPT-i M03116403L me adresë Fier lagjja 29 Nentori, rruga Dervish Hekali godina nr.2 dhe **“6D-PLAN” shpk** me nr.NIPT-i L62717405H me adresë Tirane Njesia Nr.7, Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla 3, kati i parë ofron vlerën sipas preventivit **11,973,509.42** (njëmbëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e nëntë pikë dyzetë e dy) lekë pa TVSH/ totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkisë Patos] sigurimin e kontratës (duke qënë se kjo procedurë është me bashkëfinancim me HAP, në marrëveshjen e bashkëfinancimit kërkohet që sigurimi i kontratës të jetë në bankë) dhe dokumentat origjinale ose kopje të noterizuara, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës dhe dokumentat origjinale ose kopje të noterizuara, brenda afatit përfundimtar tërhiqeni

nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj procedura do të anulohet, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesat: PO.

Ankesa elektronike printuar me datë 30/10/2021 në faqen zyrtare të KPP-së <https://kpp.al/TrajtimAnkese?id=1760>, e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik: “MODESTE” Shpk dhe “SHKELQIMI 07” Shpk për objektin e prokurimit "Rikonstruksion i ambienteve të Qendrës Shëndetësore Ruzhdie dhe Ambulancës në Dukas Çoban", duke ankimuar për skualifikimin e ofertës se tij ne procedurën e prokurimit.

Pasi ankesa u shqyrtua në AK dhe më pas në KPP ku doli Vendimi i **K.P.P.** -së nr. **123/2022** me nr. 2567/4 prot. datë 01/02/2022, me objekt *“Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Modeste” SHPK & “Shkëlqimi 07” SHPK në procedurën e prokurimit E hapur, me Nr. REF-09096-10-21-2021, me objekt "Rikonstruksion i ambienteve të Qendrës Shëndetësore Ruzhdie dhe Ambulancës në Dukas Çoban", me fond limit 12.568.796,01 (dymbëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë zero një) lekë pa TVSH, zhvilluar më date 08.11.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos”* ku në pikën 1 është vendosur të mos pranohet ankesa e paraqitur nga: Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “Modeste” SHPK & “Shkëlqimi 07” SHPK, dhe në pikën 2 Autoriteti Kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

TITULLARE E AUTORITETIT KONTRAKTOR

Rajmonda **BALILAJ**